


RAPORT MUJOR












SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

GUSHT
2024



PARAQITJA GRAFIKE E SITUATËS ME GJUHËN E URREJTJES NË GUSHT TË VITIT 2024



	Gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë nacionale	105
	Gjuhë e urrejtjes për shkak të përkatësisë etnike	39
	Gjuhë e urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor	18
	Gjuhë e urrejtjes për shkak të përkatësisë politike	16
	Gjuhë e urrejtjes në bazë të seksit dhe gjinisë	8
	Gjuhë e urrejtjes për shkak të origjinës sociale	1
	Gjuhë e urrejtjes për shkak të racës/ngjyrës së lëkurës	1
	Gjuhë e urrejtjes për shkak të statusit të migrantit ose refugjatit	1
	Shprehje talljeje ndaj përfaqësuesve të vendeve të huaja	1
	Gjuhë e urrejtjes për shkak të gjendjes shëndetësore	1
	Gjuhë e urrejtjes për shkak të pengesave intelektuale ose fizike	1

* Në platformë janë regjistruar 158 raste origjinale të gjuhës së urrejtjes - në disa prej rasteve janë regjistruar më shumë se një karakteristikë mbrojtëse.

Bashkefinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkefinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës



Gjatë muajit gusht në ueb platformën
www.govornaomraza.mk

158 janë regjistruar gjithsej
raste me elemente të gjuhës së urrejtjes,
diskriminimit dhe ngacmimit në baza
të ndryshme.

Këtë muaj janë
regjistruar

105 (55%)

raste të gjuhës së
urrejtjes për shkak të
nacionalitetit,

39 (20%)

raste në bazë të
përkatësisë etnike,

18 (9%)

raste në bazë të
orientimit seksual dhe
identitetit gjinor

16 (8%)

raste në bazë të
përkatësisë politike.

Pikërisht në fillim të gushtit në rrjetet sociale u vu re gjuha e urrejtjes e shkaktuar nga lajmi i fitores së boksieres algjeriane Iman Helif, për të cilën në media dolën informacione të pakonfirmuara se është një person interseks, me titullin “Burri biologjik ka boksuar me një grua në Lojërat Olimpike në Paris. Italianja me lot në sy e dorëzoi ndeshjen për 45 sekonda”. Titujt e tillë të publikuar nga portalet e internetit shkaktuan gjuhë të urrejtjes dhe fjalë ngacmuese të bazuara në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, të identifikuar në komente.

Më 8 gusht, në Karpallak u shënuar përvjetori i vdekjes së mbrojtësve maqedonas që humbën jetën gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001. Lajmi se është thyer pllaka përkujtimore në nderim të mbrojtësve të rënë në afërsi të Karpallakut, vetëm një ditë pas përvjetorit të vdekjes së tyre, është pritur me reagime të regjistruara në rrjetet sociale me fjalë shqetësuese dhe urrejtje në baza etnike dhe kombëtare.

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ëve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë qëndrimet zyrtare të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

